




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AKP kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në vitin 2024, AKP-ja kishte shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar ose 4,552,894€, me një rritje prej 3% në raport me vitin paraprak. Megjithatë, çështjet për përmirësim të cilat janë vërejtur gjatë auditimit kanë të bëjnë me mos funksionimin e sistemit e-pasuria si dhe emërimin dhe kompensimin e komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së menaxhmentit nga Bordi i Drejtorëve në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim është i ri dhe një (1) rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2024 ishte 3,466,480€, i cili u shpenzua plotësisht. Sipas buxhetit, numri i të punësuarve ishte 242, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 209 si dhe tetë (8) anëtarë të Bordit. Gjatë vitit 2024 u realizuan katër (4) punësime të reja.

Çështja A1 - Emërimi i Komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit nga Bordi i Drejtorëve në kundërshtim me kërkesat ligjore

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nenit 15, Përgjegjësitë e Bordit, pika 1, Bordi ka përgjegjësi të përgjithshme për aktivitetet e Agjencisë dhe për përmbushjen e kësaj përgjegjësie ndërmerr veprimet e duhura apo të lejuara me këtë ligj. Ndërsa pika 2. Vendimet e poshtëshënuara të Bordit do të merren me shumicën e kualifikuar dhe nuk mund t'i delegohen asnjë personi. Tutje, paragrafe 2.16 përcakton që përgjegjësi e Bordit është edhe miratimi i punës (performancës) së menaxhmentit në bazë të raportit vjetor të auditimit.

Më datë 7 gusht 2024, Bordi i Drejtorëve (BD) vendosi përmes vendimit që të zgjasë mandatin e Komisionit për Vlerësim dhe Raportim të Punës së Menaxhmentit të Agjencisë deri më 5 gusht 2025, duke emëruar kryetarin e ri të komisionit pas dorëheqjes së kryetarit paraprak.

Ky komision përbëhej prej tre anëtarëve të BD. Përveç kompensimit si anëtarë të rregullt të BD, vendimi përcaktojë edhe një kompensim tjetër shtesë. Kjo është një detyrë e rregullt që buron nga vetë ligji dhe është pjesë përbërëse e mandatit të tyre si organ drejtues sipas pikës 2.16 të nenit 15 të ligjit për AKP-në. Kryetari i komisionit përfiton një shtesë në vlerë prej 200€/muaj ndërsa dy anëtarët e tjerë nga 150€/muaj (e që në total kompensimi vjetor për këtë komision ishte në vlerë prej 6,420€).

Komisioni mban takime të rregullta me menaxhmentin, i cili raporton mbi realizimin e aktiviteteve bazuar në objektivat e përcaktuara. Çdo tre muaj, komisioni paraqet para Bordit lidhur me progresin e arritur mbi punën e menaxhmentit. Pastaj Bordi i drejtorëve me rekomandimin e këtij komisioni vendos përfundimisht mbi vlerësimin e performancës së tyre si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë.

Pavarësisht që komisioni raporton rregullisht dhe BD merr vendimin përfundimtar, procesi nuk është në përputhje me ligjin sepse vlerësimi i performancës është kompetencë e plotë e BD-së si dhe nuk mund të delegohet dhe kompensohet shtesë.

Emërimi i komisionit ishte bërë me qëllim të shmangies së mbledhjeve të të gjithë anëtarëve të Bordit për vlerësim të menaxhmentit me arsyetimin e efikasitetit të punës së BD-së.

Ndikimi

Krijimi i një komisioni për vlerësimin e menaxhmentit nga Bordi i drejtorëve, i cili jep rekomandime në emër të Bordit të Drejtorëve, rezulton në devijim nga kërkesat ligjore dhe rrezik për cenimin e procesit të vlerësimit të performancës. Po ashtu, kompensimi shtesë për anëtarët e komisionit për një detyrë që ligjërisht i përket BD-së paraqet një shpenzim të panevojshme

duke ndikuar buxhetin e Agjencisë.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se vlerësimi i menaxhmentit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nuk i delegohet asnjë personi/komisioni tjetër. Për më tepër, të siguroj që për detyrat që janë pjesë e përgjegjësive të tyre të rregullta të mos bëhet asnjë kompensim shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 88,560€, pasurive jokatitale është 94,392€, si dhe e stoqeve 13,857€.

Çështja B1 - Mos funksionimi i sistemit "e-pasuria"

Gjetja

Sipas nenit 6.3 të rregullores 02/2013 për Menaxhim të Pasurive jo financiare: Pasuria kapitale do të regjistrohet në SIMFK ndërsa ajo jo-kapitale dhe stoqet në sistemin e-pasuria.

Gjatë vitit 2024, AKP përkundër veprimeve që kishte ndërmarr për adresimin e rekomandimit të vitit të kaluar, duke vazhduar komunikimet zyrtare me kompaninë përgjegjëse për vendosjen e shënimeve në sistemin e-pasuria, as këtë vit nuk kishte arritur që të funksionalizojë këtë sistem.

Për menaxhimin e brendshëm dhe raportimin e pasurisë jo kapitale, AKP vazhdojë të përdorte regjistrin e tyre të brendshëm në formatin Excel.

Kjo kishte ndodhur për shkak të problemeve gjatë vendosjes së shënimeve në sistem e-pasuria, si dyfishim i të dhënave, artikuj me vlerë zero si dhe artikuj me vlerë të shumëfishuar.

Ndikimi

Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore për menaxhim të pasurisë. Gjithashtu, përdorimi i Excel-it për regjistrimin e pasurive jo kapitale, ku ndryshimet mund të bëhen në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun që informatat e shpalosura në PFV mund të jenë të pasakta dhe jo të plota.

Rekomandimi B1

Bordi i Drejtorëve duhet të ndërmarrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion të plotë sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikut të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	4,575,686	4,704,686	4,552,894	4,594,243	5,944,598
Grante Qeveritare - Buxheti	4,575,686	4,704,686	4,552,894	4,594,243	5,944,598

Buxheti përfundimtar rezultojë të jetë 129,000€ më i lartë se buxheti fillestar. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i tri vendimeve të Qeverisë (Nr. 22/233, Nr. 14/238 dhe Nr. 03/239), të cilat përfshinin shtesë në paga dhe kursime në kategoritë e shpenzimeve në organizatat buxhetore.

Në vitin 2024, AKP-ja ka shpenzuar 97% të buxhetit përfundimtar, ose 4,552,894€, ku krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 3% (2023 - 94%). Megjithatë, totali i shpenzimeve në vitin 2024 kishte një zvogëlim rreth 1% në raport me vitin paraprak. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	4,575,686	4,704,686	4,552,894	4,594,243	5,944,598
Pagat dhe mëditjet	3,091,304	3,466,804	3,466,481	3,619,603	4,926,016
Mallrat dhe shërbimet	1,069,382	1,027,882	924,047	879,369	883,787
Komunalitë	150,000	150,000	106,178	82,572	100,680
Subvencionet dhe transferet	5,000	0	0	0	0
Investimet Kapitale	260,000	60,000	56,188	12,700	34,115

AKP kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori, mirëpo të gjitha ato ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 375,500€, përmes vendimit të Qeverisë Nr. 22/233 të datës 27.11.2024 dhe vendimit Nr. 03/239 të datës 24.12.2024, të cilat alokuan buxhet shtesë për mbulimin e pagave të stafit të AKP-së. Buxheti final ishte realizuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 41,500€, si rezultat i vendimit të Qeverisë Nr. 14/238 të datës 18.12.2024 për kursime buxhetore. Buxheti final ishte realizuar në masën prej 90%;
- Buxheti final për shpenzimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar mbeti i pandryshuar. Realizimi i shpenzimeve 71% e buxhetit;
- Buxheti fillestar për subvencione dhe transfere ishte në vlerë 5,000€. Me vendim të Qeverisë Nr. 14/238 të datës 18.12.2024 ky buxhet ishte marr si kursim buxhetor për shkak të mos shpenzimit; dhe
- Buxheti final për investime kapitale, krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 200,000€. Ky ndryshim është bërë me vendim të Qeverisë Nr. 14/238 për kursime buxhetore. Buxheti final ishte realizuar në masën prej 94%.

AKP-ja gjatë dy viteve të fundit nuk kishte realizuar të hyra.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0			1,220
Të hyrat jo tatimore	0	0			1,220

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të AKP-së ka rezultuar me tre (3) rekomandime. AKP kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2024, dy (2) rekomandime janë zbatuar, ndërsa një (1) ende nuk është zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 ose (Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që komisioni i vlerësimit kryen vlerësimin në pajtueshmëri të plotë me kërkesat që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.	Gjatë testimit është konfirmuar se nuk ka pasur raste të ngjashme.	I zbatuar
2.	Çështjet e përbashkëta	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që, urdhër blerjet lëshohen para se të pranohen mallrat dhe faturat, në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.	Është konfirmuar se janë ndërmarrë veprime për implementimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion të plotë sistemin e-pasuria.	Edhe këtë vit nuk është funksionalizuar sistemi e-pasuria. Shih çështjen B1.	Nuk është adresuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Emërimi i Komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit nga Bordi i Drejtorëve në kundërshtim me kërkesat ligjore	Në lidhje me pretendimin se emërimi dhe kompensimi i Komisionit për Vlerësim dhe Raportim të Punës së Menaxhmentit është në kundërshtim me kërkesat ligjore, dëshirojmë të theksojmë sa vijon: 1. E drejta statutore për krijimin e komisioneve Bordi i Drejtorëve, në përputhje me Statutin e Agjencisë (neni 12), ka të drejtë të caktojë komisione të përhershme ose të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta që kërkojnë analizë të thelluar dhe angazhim të posaçëm. Në këtë bazë është themeluar Komisioni për Vlerësim dhe Raportim të Punës së Menaxhmentit si një trup funksional ndihmës, pa cenuar kompetencat vendimmarrëse të Bordit. 2. Funksioni ndihmës, jo delegues i komisionit Ky komision nuk ushtron kompetenca vendimmarrëse dhe nuk zëvendëson rolin e Bordit në vlerësimin e performancës së menaxhmentit. Ai shërben si një mekanizëm mbështetës, që përgatit materiale, bën vlerësime të rregullta dhe sjell para Bordit analizat e nevojshme për të mundësuar vendimmarrje më të informuar. Vendimi përfundimtar për vlerësimin e performancës mbetet gjithmonë në kompetencën ekskluzive të Bordit, në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-034. Si dëshmi për këtë, po bashkëngjisim dy dokumente që pasqyrojnë qartë veprimet zyrtare dhe vendimmarrjen e Bordit: • Raportin tre mujor të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së	Kompetenca sipas Nenit 15, paragrafi 2.16 i Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-në (i ndryshuar me Ligjin Nr. 06/L-023): Ky nen i njeh Bordit të Drejtorëve kompetencën për të miratuar performancën e menaxhmentit në bazë të raportit vjetor të auditimit. Kjo është një detyrë e rregullt që buron nga vetë ligji dhe është pjesë përbërëse e mandatit të tyre si organ drejtues. Për këtë arsye, krijimi i ndonjë komisioni të veçantë për këtë funksion nuk mund të justifikojë ndonjë kompensim shtesë financiar, pasi detyra nuk përbën funksion të jashtëzakonshëm apo shtesë.

Menaxhmentit, të themeluar nga vetë Bordi i Drejtorëve;
 • Vendimin e Bordit për shqyrtimin dhe miratimin e Raportit tre mujor në fjalë.

3. Ligjshmëria e pagesës shtesë për anëtarët e komisionit

Asnjë dispozitë e Ligjit për AKP-në dhe asnjë rregullore e brendshme nuk ndalon dhënien e kompensimit shtesë për anëtarët e Bordit që marrin pjesë në komisione të veçanta të themeluara nga vetë Bordi. Kompensimi është vendosur me vendim të Bordit, në përputhje me nevojën për të shpërblyer angazhimin shtesë dhe përgjegjësinë që rrjedh nga puna përgatitore që është mjaft intensive.

4. Praktikë e konsoliduar dhe e audituar më parë

Kjo praktikë ka qenë e zbatueshme edhe më herët dhe është audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, (në vitet 2022 dhe 2023), e cila nuk ka dhënë asnjë vërejtje në këtë drejtim.

Kjo dëshmon se kompensimi është konsideruar në përputhje me kornizën ligjore. Megjithatë, nëse konstatohet se kjo praktikë duhet ndaluar ose rishikuar, Bordi mbetet i hapur për ta pezulluar menjëherë. Në përgjithësi, konsiderojmë se gjetja, lidhur me emërimin e Komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit, nuk reflekton saktë qëllimin dhe praktikën e ndjekur nga Bordi i Drejtorëve, e cila është në përputhje me ligjin, statutin, praktikat e mira të qeverisjes dhe transparencën në procesin e vlerësimit të menaxhmentit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIK E KOSOVË	
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
Nr. Br. No. 1771	
Nr. 3	
Nr. 04.04.2025	
Nr. 04.04.2025	

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: **Vlora Spanca**
Auditore e Përgjithshme
Zyra Kombëtare e Auditimit


E nderuar Znj. Spanca,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIK E KOSOVË			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANIMIT / DATE OF RECEIPT: 04.04.2025			
Nr. Org. / Org. No.	Nr. Klasif. / Class. Code	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr. Ekipa / E. Stranica
05	48	440	3

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin e çështjes B1 dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- Nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin të çështja A1 që kemi komente dhe kundërshtim; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit Final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,



Ibrahim Gjylderen
U.D. Drejtor Ekzekutiv
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Data: 03 prill 2025

Në shtojcë:

Letër komformimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.